



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** dhe nenit 14, paragrafi **1** i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 21, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019), nenit 24, paragrafi 2, të Rregullores QRK, nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 33.2, shkronja **a**, nenit 34.1 shkronja **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010 dhe kërkesës nr. 13-353/01-39193/22, dt. 23.02.2022, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 28.04.2022, mori këtë

V E N D I M
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS
AGJENCISË SË USHQIMIT DHE VETERINARISË

- I.** **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.
- II.** Prona e paluajtshme e dhënë në shfrytëzim, e cekur në pikën I të këtij vendimi, është:
 1. Pjesa e parcelës kadastrale, me nr. P-71914024-00670-2, në sipërfaqe 2160 m².
- III.** Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, të cekur në pikën II të këtij vendimi, është dhënia në shfrytëzim e pronës komunale, e cila është kërkuar nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, për çasje në lokacionin ku është planifikuar të ndërtohet objekti për varrosjen – groposjen e kafshëve.
- IV.** Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, e cila shtrihet në parcelën kadastrave, nr. P- 71914024-00670-2, Zona kadastrale Bërnice e Poshtme, në pronën e paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën II të këtij vendimi, është (10) dhjetëvjeçar, duke e ruajtur të drejtën e ndërprerjes së kontratës në raste specifike.
- V.** Prona e paluajtshme e cekur në pikën II të këtij vendimi, jepet në shfrytëzim pa kompensim.
- VI.** Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesit të shfrytëzuesit.

- VII.** Prona e paluajtshme komunale që jepet në shfrytëzim, e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastralë të Komunës.
- VIII.** Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe drejtoritë kompetente të Komunës së Prishtinës.
- IX.** Pjesë përbërëse e këtij propozimvendimi janë:
- kërkesa,
 - kopja e planit dhe certifikata e pronës.
- X.** Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/06-94228/22, më 29.04.2022

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupa



Arsyetim

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, me shkresën nr. 13-353/01-39193/22, të datës 23.02.2022, ka kërkuar nga Drejtoria e Pronës shfrytëzimin e pronës komunale, pjesën e parcelës kadastrale, me nr. P-71914024-00670-2, në sipërfaqe prej 2160 m², Zona kadastrale Bërnice e Poshtme, për qasje në lokacionin ku është planifikuar të ndërtohet objekti për varrosjen – groposjen e kafshëve.

Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën II të këtij propozimi, është për 10 vjet, duke e ruajtur të drejtën e ndërprerjes së kontratës në raste specifike. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës do të caktohen me kontratë, të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe shfrytëzuesit.

Andaj, duke u bazuar në dispozitat ligjore si në pjesën hyrëse të këtij Propozimi, kërkesës nr. 13-353/01-39193/22, dt. 23.02.2022, dhe në shkresat e lëndës, u vendos si në dispozitiv të këtij propozimi.